



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 34

Tiranë – E mërkurë, 11 mars 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr.2, datë 11.3.2020	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” 2839
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.207, datë 10.3.2020	Për dhënie shpërblimi për personelin, mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerë..... 2839
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 131, datë 8.3.2020	Për ndalimin e eksportit të barnave dhe të pajisjeve mjekësore..... 2840



AKT NORMATIV
Nr. 2, datë 11.3.2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR.15/2016, “PËR
PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E
INFEKSIONEVE DHE SËMUNDJEVE
INFEKTIVE”

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në shkronjën “c”, të nenit 7, pas fjalës ”... izolimi ...” shtohet fjala “... vetëkarantinim ...”.

Neni 2

Pas pikës 5, të nenit 21, shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

“5.1. Në rast të një epidemie, fatkeqësie natyrore, aksidenti të rëndë, që mund të favorizojë shpërthime epidemike, për të siguruar zbatimin e masave parandaluese, sipas këtij ligji, angazhohen Policia e Shtetit dhe Forcat e Armatosura, në ndihmë të saj. Policia e Shtetit angazhohet me kërkesë të ministrit përgjegjës për shëndetësinë. Forcat e Armatosura angazhohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, pas kërkesës së ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike. Kur angazhohen Forcat e Armatosura, ato drejtohen nga komandantët, sipas detyrave që marrin.”.

Neni 3

Në nenin 35, “Kundërvajtje administrative”, bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1.. Shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “dh” ndryshohen, si më poshtë vijon:

“b) Mosmarrja e masave të përgjithshme, sipas përcaktimeve të bëra në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e”, dhe “f”, të nenit 6, të këtij ligji, dënohet me gjobë, nga 500 000 (pesëqind mijë) deri në 700 000 (shtatëqind mijë) lekë dhe, në rast përsëritjeje, me mbyllje të veprimtarisë;

c) Mosmarrja e masave të veçanta, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 7, të këtij ligji, dënohet me gjobë, nga 100 000 (njëqind mijë) deri në 700 000 (shtatëqind mijë) lekë;

ç) Refuzimi për vendosjen nën mbikëqyrje shëndetësore, sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 17, dënohet me gjobë 100 000 (njëqind mijë) lekë, për personin, objekt i mbikëqyrjes shëndetësore, dhe 700 000 (shtatëqind mijë) lekë për punëdhënësin e tij;

dh) Moskryerja e veprimeve të detyrueshme për përballimin e epidemive, sipas përcaktimit të bërë në nenin 21, të këtij ligji, dënohet me gjobë, nga 100 000 (njëqind mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë, dhe me mbyllje të veprimtarisë.”.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1.1, me këtë përmbajtje:

“1.1 Masa e gjobës dhe/ose masa të tjera administrative për moszbatimin e masave të përgjithshme dhe të veçanta, përkatësisht, sipas neneve 6, pika 2, dhe 7, pika 5, të këtij ligji, përcaktohen në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 4

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 207, datë 10.3.2020

PËR DHËNIE SHPËRBLIMI PËR
PERSONELIN, MJEKË, INFERMIERË
DHE PUNONJËS TË TJERË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Dhënien e shpërblimit mujor, në masën 125 000 (njëqind e njëzet e pesë mijë) lekë, për personelin mjekësor, specialistë të shëndetit publik që merren me epidemiologjinë, infermierë dhe specialistë të shërbimit laboratorik, të angazhuar në diagnostikimin dhe trajtimin mjekësor të personave të prekur nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19.

2. Dhënien e shpërblimit mujor, në masën 65 000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë), lekë, për personelin mbështetës, i angazhuar në institucionet ku trajtohen personat e prekur nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19.

3. Shpërblimi, sipas pikës 1, të këtij vendimi, do t'u jepet edhe mjekëve dhe infermierëve që kanë dalë në pension dhe dëshirojnë të ofrojnë shërbim shëndetësor për trajtimin e personave të prekur nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19.

4. Lista emërore e përfituesve, përfshirë ditët e angazhimit, sipas pikave 1, 2 dhe 3, të këtij vendimi, miratohet çdo muaj me urdhër të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

5. Fondi për shpërblimin e personelit, mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerë, sipas pikave 1, 2 e 3, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, për vitin 2020.

6. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

URDHËR
Nr. 131, datë 8.3.2020

**PËR NDALIMIN E EKSPORTIT
TË BARNAVE DHE TË PAJISJEVE
MJEKËSORE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, pika 3, germa “c”, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”; të vendimit të datës 8.3.2020 të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri”, si
Faqe | 2840

edhe në përputhje me Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit, me qëllim marrjen e masave për mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e eksportit të barnave dhe të pajisjeve mjekësore nga Republika e Shqipërisë deri në një urdhër të dytë.

2. Eksporti i barnave dhe i pajisjeve mjekësore do të kryhet vetëm me autorizim të posaçëm të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

3. Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore të ndërmarrë të gjitha veprimet në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, për zbatimin e këtij urdhri.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore dhe të gjitha subjektet që kryejnë eksport të barnave dhe pajisjeve mjekësore nga Republika e Shqipërisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 56 lekë